



## SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Doctor Exterminator DDD" Sh.P.K. të datës 03.10.2023 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "36 DDD objekteve të KPSH" me nr. të prokurimit 616-24-9594-2-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Doctor Exterminator DDD" Sh.P.K. të datës 03.10.2023 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "36 DDD objekteve të KPSH" me nr. të prokurimit 616-24-9594-2-2-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "Doctor Exterminator DDD" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 03.10.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "36 DDD objekteve të KPSH" me nr. të prokurimit 616-24-9594-2-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.



**Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:**

“AK në pikën 7.1 dhe 7.2, për përshtatshmërinë profesionale në pikën 5, të FDT, lidhur me pyetjen se pse duhet që kopja e akreditimit të jetë në verzionin shqip dhe anglisht të organizatës që e ka lëshuar çertifikatën ISO, kurse sipas përgjigjes se AK, ceket se “Pika 5) Kopja e akreditimit të organizatës që ka lëshuar certifikatat ISO është e domosdoshme për të siguruar që standardet e cilësisë, menaxhimit të cilësisë, dhe praktikave operacionale të OE janë vërtetuar dhe certifikuar nga një organ i akredituar ndërkombëtar. Kjo siguron që certifikatat e ofruara janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe janë lëshuar nga një institucion i njohur që vepron sipas praktikave dhe rregullave të ISO-së. Versionet në gjuhën shqipe dhe angleze janë të nevojshme për të garantuar qartësi dhe transparencë në prokurim, veçanërisht në komunikimin me palët e ndryshme dhe për të siguruar përputhshmërinë ndërkombëtare të dokumentacionit të certifikimit”, por që konsiderojmë se kjo është një kërkesë gabim dhe e panevojshme për shkak se akreditimi si kopje lëshohet konform standardeve ndërkombëtare dhe në gjuhën angleze, pasi që konsiderojmë se përgjigja është konfuze dhe e paqartë, sepse përputhshmeria ndërkombëtare vërtetohet me dokumentacionin e akreditimit në gjuhën angleze, që është dokumentacion origjinal”.

“AK konsiderojmë se ka bërë shkelje ligjore sipas nenit të lartë cekur edhe me faktin se në pikën 9.1 dhe 9.2 të Kapaciteti teknik dhe profesional, lidhur me pyetjen e OE ankues “Ju lutem na sqaroni se çka nënkuptoni me produktet të përfshira në listën e kontratave të realizuara në 3 vitet e fundit”, në përgjigjen e AK ceket se “Produktet e përfshira në listën e kontratave të realizuara në 3 vitet e fundit: Për “produktet e përfshira” nënkuptohet se duhet të ofrohet një përshkrim i shërbimeve apo mallrave specifike që janë përfshirë në zbatimin e kontratave përkatëse. Kjo përfshinë secilin projekt apo kontratë të kryer në 3 vitet e fundit për shërbime DDD”, konsiderojmë se një kërkesë e tillë sa i përket produkteve të përfshira është e panevojshme për shkak se përgjigja juaj është e paqartë dhe konfuze sepse kompanitë e DDD, nuk kanë të bëjnë me produktet e përfshira apo mallërat specifike, por me shërbimet e DDD-së, gjatë këtyre tri viteve të fundit, kështu që si kërkesë duhet të ndërrohet-hiqet dhe të lihet vetëm paraqitja e kontratave të kryera në 3 vitet e fundit për shërbime DDD”.

“AK në specifikacionin teknik në pikën 9.1 dhe 9.2 të Kapaciteti teknik dhe profesional, lidhur me pyetjen e OE ankues sipas pikës A “ju lutem të na sqaroni pse për epidemiolog kërkohet diplomë universitare e jo licencë e punës”. Në përgjigjen nga AK “Diploma ose licenca për Epidemiologun: Diplomimi ose licencimi i Epidemiologut kërkohet për të garantuar se individi është i kualifikuar për të ofruar shërbime që lidhen me parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve që mund të përhapen nga insektet dhe dëmtuesit. Ky kualifikim është kritik për të siguruar cilësi në zbatimin e masave DDD (Dezinsektim, Dezinsektim, Deratizim)”. Konsiderojmë se kjo është kërkesë e gabuar për shkak se licenca e punës për këtë veprimtari jepet mbi bazën e diplomës dhe kushteve tjera, andaj më e logjikshme duhej të ishte që për epidemiolog të kërkohet licenca e punës sesa diploma, OE ankues këtë kriter e konsideron si diskriminues dhe favorizues për ndonjë OE tjetër i cili mund të ketë epidemiolog me diplomë por jo edhe me licencë të punës”.



“AK ka vazhduar sipas specifikacionit teknik në pikën 9.1 dhe 9.2 të Kapaciteti teknik dhe profesional sa i përket se pse duhet të ketë OE një inxhinier sanitar dhe çfarë funksioni ka i njëjti në këtë shërbim. AK në përgjigjen e saj ka theksuar se “Licenca për Inxhinierin Sanitar në shërbimet DDD: Kërkohet për të vërtetuar që Inxhinieri Sanitar ka njohuritë e nevojshme për të planifikuar dhe implementuar strategji të kontrollit të dëmtuesve, për të mbrojtur shëndetin publik dhe për të siguruar standarde të larta sanitare gjatë ofrimit të shërbimeve DDD”. Konsiderojmë që kjo kërkesë e FDT-së është e panevojshme për faktin se shërbimet që do të kryen sipas kësaj kontrate janë shërbime të DDD-ve dhe inxhinieri sanitar nuk është i nevojshëm, dhe si i tillë duhet të hiqet për shkak se profesioni i tij është për ujëra të zeza, mbeturina dhe nuk ka lidhje fare me shërbimet e DDD (Me një klikim në google mund ta vërtetoni këtë pretendim), OE ankues këtë kriter e konsideron si favorizues për ndonjë OE tjetër i cili mund të ketë inxhinierin sanitar”.

“Në pyetjen tjetër të OE se pse duhet të jetë një ekolog dhe për çfarë funksioni shërben i njëjti në shërbimet e DDD-ve dhe pse për ekolog nuk është kërkuar licenca e punës, AK në përgjigjen e saj ka theksuar se “Licenca për Ekologun dhe funksioni i tij: Ekologu është i specializuar në menaxhimin e dëmtuesve duke marrë në konsideratë ndikimin mjedisor të shërbimeve DDD. Funksioni i tij është të sigurojë që çdo ndërhyrje që bëhet për kontrollin e dëmtuesve të jetë e qëndrueshme dhe në përputhje me standardet ekologjike për të minimizuar dëmin ndaj mjedisit. Nëse ekologu posedon license, mund të ofroj por ne si AK nuk e kemi kërkuar”. Ne si OE konsiderojmë që ekologu në shërbimet e DDD-së dhe funksionit që kryejnë DDD-të nuk është fare i nevojshëm për sa kohë është Epidemiologu (Me një klikim në google mund ta vërtetoni këtë pretendim), konsiderojmë që këto kritere përpos që janë diskriminuese për OE njëkohësisht janë favorizuese dhe nuk sigurojnë trajtim të barabartë në mes të OE-ve”.

“Nga praktikat e kaluara të shërbimeve të DDD-së, në hapësirat publike të KPSH, nuk është e nevojshme të ketë 10 puntorë të trajnuar në Pest Control & Management, kur nga praktikat e kaluara të periudhes mbi 20 vjeçare të njëjtat shërbime janë kryer me 5 ose 6 puntorë, andaj OE ankues këtë kriter e konsideron si diskriminues dhe favorizues për ndonjë OE tjetër, që ka këtë numër të puntorëve”.

“Në pyetjen e OE “sqaroni se pse OE duhet të ketë në staf të certifikuar për shëndet publik dhe pesticide”, AK në përgjigjen e saj ka theksuar se “Siguria në hapësirat publike dhe oborret e shëndetësore- Përmbushja e standardeve ligjore. Ky staf trajnuar është i domosdoshëm për aplikimin e duhur në ambiente që kërkojnë kujdes të veçantë, si hapësirat publike dhe oborret e objekteve shëndetësore me bimësi”, ne si OE konsiderojmë që ky kriter është favorizues dhe nuk garanton trajtim të barabartë pasi që ligjërisht çdo OE që merr leje dhe licencë për shërbimet e DDD-ve e merr mbi bazën e përgatitjeve profesionale të certifikuar të stafit, e njëjta gjë është edhe sa i përket pyetjes nga OE se “pse duhet të ketë një punëtor të trajnuar për rezistenca antimikrobike, parandalimin dhe kontrollimin e infeksioneve në institucionet shëndetësore”. Fillimisht AK nuk e ka të qartë se institucionet e KPSH-së, duhet të kenë staf të vetë të trajnuar e jo OE që nuk ka lidhje me rezistencën antimikrobike dhe rezistencën ndaj antibiotikeve, por mirret me shërbimet e DDD-së, e cila kryhet në gjatë faza. Prandaj ne si OE konsiderojmë që ky kriter dhe ky lloj i certifikimit/trajnitimit për rezistencë antimikrobike është duke ju përshtatur apo parapërgatitur ndonjë tenderuesi potencial me qëllim të eliminimit të OE tjerë që nuk kanë këtë



punëtor të trajnuar për këto gjëra Për sqarim puntori i certifikuar për rezistencen antimikrobike nuk ka të bëjë fare me shërbimet e DDD-së”.

“Në pyetjen e tretë të OE lidhur me atë se a është duke u bërë dezinfektimi hapësinor apo shërbimet e DDD-ve, AK është përgjigjur se “Sqarohet se shërbimi DDD do të implementohet në të gjitha objektet e KPSH-së, si dhe në hapësirat publike përfshihen dezinfektimi dhe deratizimi i hapësirave të jashtme (oborre)”, konsiderojmë se përpos që përgjigja e AK, nuk është e saktë por nuk është as e plotë, për shkak se dezinfektimi hapësinor punohet vetëm gjatë natës dhe gjatë kohës kur shtohet numri i vektorëve në kohën e pranverës se vonshme dhe verës (mushkonjave dhe insekteve tjera), ashtu që spjegimi juaj është i paqartë, konfuz dhe i mangët, e si kriter duhet hequr krejt, dhe nëse shikohet i gjithë dezinfektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës ka përfunduar, dhe behet çdo vit duke përfshirë edhe hapësirat e KPSH, kështu që ULV gjeneratorët dhe fumigatorët, duhet të hiqen komplet”.

“Në pikën dy kur është kërkuar në pikën “2 OE duhet të posedoj ULV elektrike modeli i pikave 0-30 mikron në shkallë të aplikimit ULV elektrike është rezultat i zhvillimit të mëtejshëm të vazhdueshëm për të lehtësuar funksionimin dhe trajtimin në hapësira të brendshme, megjithatë, pajisja duhet të lejon njësinë të rrotullohet automatikisht midis 90° dhe 360° në mënyrë që të mbulohet hapësira ku trajtohet deri në një nivel të lartë dhe mos të lër njolla(pika) gjatë aplikimit të biocidit/insekticidit”, ky është kriter diskriminues për ndonjë OE që ka këto paisje pasi që të njëjt punë dhe shërbim mund të kryer vetëm një punëtor me ULV elektrike, andaj është kriter diskriminues dhe duhet të hiqet. (Lind një pyetje si mund të lihet ULV elektrike që rrotullohet automatikisht midis 90° dhe 360°, e cila gjatë gjithë kohës liron biocide insekticide, e që në mënyrë automatike rrezikon jetën e pacientëve dhe punëtorëve, prandaj edhe ekziston edhe metodologjia e punës ku puntori bënë aplikimin e biocideve në sasinë e nevojshme gjatë fazave)”.

“Në pyetjen e OE “Ju lutem te na sqaroni pse duhet OE te kete minimum nje ULV aerosol përgjigjet se “Përdorimi i pajisjeve ULV për dezinfektim: Kërkesa për pajisje ULV me kapacitete specifike (p.sh., rezervuare, mikroçipë për kontroll të mjegullimit, etj.) është për të garantuar që operatori ekonomik ka kapacitetin teknologjik për të kryer dezinfektime të avancuara dhe efektive në përputhje me standardet e shëndetit publik”, përgjigja është tejet jo profesionale dhe jo e qart për shkak se në fillim e keni cekur “dezinfektim”, kurse ne fund të përgjigjes ceket se kjo është për të “kryer dezinfektime të avancuara”, si dhe dy rezervuare 6.5 litera dhe 20 liter dhe zorrë 5m, ku këto kritere duket se ju janë përshtatur ndonjë OE që ka fiks këtë model dhe sasi (sepse këto rezervuare mund të rimbushen për shkak se as me 6.5 litra, nuk mund të përfundohet shërbimi, prap duhet rimbushur edhe ky rezervuar), për atë arsye mund të ketë edhe rezervuar edhe më të vogël dhe atë edhe pa zorr fare. Ky kriter duhet të hiqet krejtësisht. Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje ligjore përseri sepse në pyetjen e OE “Ju lutem te na sqaroni pse OE duhet te kete 5 pajisje per pastrimin e ajrit brenda objektit qe largon grimca pm 2.5 dhe pm10 si dhe largimin e viruseve dhe ju lutem te na sqaroni cfare kapaciteti kane keto 5 pajisje per pastrimin e ajrit dhe sa m3 (kub) pastrojn?”.

“AK përgjigjet se “Pika 4 - Kapaciteti për pastrim të ajrit dhe largim grimcash: Kërkohe që OE të ketë pajisje të posaçme për pastrim të ajrit në objekte, me qëllim largimin e ndotësve si viruse, grimca pm2.5 dhe pm10. Këto pajisje janë kritike për sigurinë e shëndetit publik, sidomos në



*hapësirat e brendshme të ndjeshme si objektet e KPSH-së". Ak nuk është përgjegjur në pyetje se sa ka kapacitet për pastrim një pasije (kur janë kërkuar 5 paisje me kapacitet 100 metra katror për një pasije), kurse këtu është fjala për trajtimin e 21.000 e më shumë metra katror. Kështu që a duhet të kërkoheshin nga OE më se paku 210 apratura për pastrim në bazë të kapacitetit. Andaj si kërkesë në dosjen e tenderit duhet hequr në tërësi".*

*"Ky kriter i përcaktuar është kundërligjor për faktin se ndërmarrjet apo OE që kanë mbi 10 punëtor kërkohej që të kenë raport mbi vlerësimin e riskut në vendin e punës, kurse kërkesa që një ndërmarrje të ketë 15 punëtor të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë nuk ka të bëjë fare me rastin konkret".*

*"AK ka vazhduar me shkelje ligjore kur ka kërkuar lejen për importin e produkteve biocide, deklaratën origjinale për preparatet që aplikon dhe deklaratën për produkte me specifikim teknik. Si OE është parashtruar pyetja se pse duhet të ketë licencë të importit të produkteve biocide, insketicide kur nuk ka specifikim teknik fare në dosjen e tenderit, kurse në përgjigjen e AK-së është theksuar se "Licenca për import të produkteve biocide: Kërkohej që OE të ofrojë dokumentacionin që tregon se kanë të drejtën e importit të produkteve biocide/insekticide, të cilat janë thelbësore për zbatimin e shërbimeve të DDD, si dhe deklaratën për përputhshmërinë teknike të produkteve origjinale, e nenshkruar dhe vulosur nga OE. Kjo dhe të gjitha kërkesat janë shumë e karta andaj referohuni FDT-së", ne si OE ankues konsiderojmë se kjo përgjigje për pos që është injoruese është edhe jo profesionale për faktin se në tërë dosjen e FDT-së, nuk ceket asnjë produkt biocid, insketicid pra nuk ka specifikim teknik fare në dosjen e tenderit lidhur me këtë".*

**Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit**, fillimisht duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve/përshkrimeve të ofruara nga njësia kërkuese.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet theksuar se të gjitha pretendimet ankimore lidhen me pyetjet që parashtruesi ka bërë për sqarime shtesë. Me këtë rast AK ka ofruar të gjitha sqarimet shtesë të nevojshme me datë 30.09.2024 dhe qëndron prapa tyre. Me fjalë të tjera të gjitha dilemave të prezantuara përmes këtyre pretendimeve ankimore, tanimë AK u ka dhënë përgjigje përmes sqarimeve shtesë të dt. 30.09.2024. Kërkesat e parashtruesit për të ndryshuar shumicën e kërkesave të dosjes së tenderit jo vetëm që janë të pabazuara mirëpo nëse do të merreshin parasysht do të manifestonin shkelje të hapur të parimit për mosdiskriminim/favorizim sipas nenit 7 të LPP duke përshtatur shumicën e kërkesave vetëm sipas pretendimeve të parashtruesit. Ngjashëm edhe kërkesa e parashtruesit për anulim në tërësi të AP nuk gjen mbështetje në nenin 62 të LPP.

Sa i përket pretendimeve tjera ankimore, AK konfirmon se të gjitha kërkesat e DT janë hartuar në përputhje të plotë me LPP në fuqi dhe si të tilla janë të domosdoshme për të realizuar me sukses shërbimet, duke marrë parasysh natyrën, qëllimin dhe kompleksitetin e aktivitetit të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 08.10.2024**

**Visar SHEHU**

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.